



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 17.02.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Oerd Bylykbashi– nënkryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar”.

Marrin pjesë:

Oerd Bylykbashi, Bashkim Fino, Blendi Klosi, Pandeli Majko, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Vexhi Muçmataj, Tom Doshi, Silva Caka, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Armando Prenga, Pirro Lutaj, Xhemal Qefalia.

Mungojnë: Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Vasilika Hysi, Mhill Fufi.

Të ftuar:

Marsida Fetishi - juriste në Sektorin Juridik dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në drejtorinë e Financave, Shërbimeve Mbështetëse dhe Mbikëqyrjes Shtetërore pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar

Enton Sadiku – përgjegjës sektori pranë drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar

HAPET MBLEDHJA

Oerd Bylykbashi - Fillojmë mbledhjen e komisionit.

Në mungesë të kryetarit, sot mbledhjen e drejtoj unë, në cilësinë e nënkryetarit të komisionit.

Në rendin e ditës kemi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Rumanisë për mbrojtjen e ndërsjellë të Informacionit të Klasifikuar”.

Të pranishëm nga drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar janë zonja Marsida Fetishi, juriste në Sektorin Juridik dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Drejtorinë e Financave, Shërbimeve Mbështetëse dhe Mbikëqyrjes Shtetërore, si edhe zoti Enton Sadiku, përgjegjës sektori.

Relator është zoti Klosi. Para se të marrë fjalën zoti Klosi, shkurtimisht të bëhet një prezantim për komisionin nga përfaqësuesit e DSIK-së, në lidhje me projektligjin që kemi për shqyrtim.

Marsida Fetishi - Ju kërkoj ndjesë, sepse duhet të ishte drejtori i DSIK-së, por në këto momente në ambientet e DSIK-së është duke u zhvilluar ceremonia e nënshkrimit të marrëveshjes me Spanjën. Ishte e planifikuar në orën 10:00, prandaj u bë ky ndryshim.

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar nënshkruan marrëveshje, zakonisht janë standarde për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare. Kjo e drejtë lind nga neni 24 i ligjit “Për informacionin e klasifikuar”, të ndryshuar ku përcaktohet se para nënshkrimit të një marrëveshjeje apo protokolli teknik që përfshin shkëmbimin e informacionit të klasifikuar, duhet të jetë lidhur me parë marrëveshja për sigurimin e informacionit të klasifikuar midis autoritetit dhe sigurimit kombëtar të shteteve.

DSIK-ja ka nënshkruar 22 marrëveshje sigurie me shtete të ndryshme. E fundit është me Italinë, që është nënshkruar në muajin dhjetor të vitit 2014. Ne jemi në proces, sot po nënshkruhet marrëveshja me Mbretërinë e Spanjës. Jemi në proces të negociatave me BE-në. Kjo është një marrëveshje sigurie shumë e rëndësishme për ne. Nuk kemi filluar negociatat siç është termi i mirëfilltë, siç e përcakton ligji, por kemi bërë një takim paraprak në Bruksel për fillimin e këtyre negociatave.

Marrëveshja me Rumaninë është nënshkruar në muajin nëntor të vitit 2013.

Faza e parë e negociatave është bërë në Bukuresht në muajin maj të vitit 2014.

Faza e dytë është bërë në muajin prill të vitit 2012 në Tiranë dhe është nënshkruar në nëntor të vitit 2013. Kam përshtypjen se e dini që çdo marrëveshje është tip, përcaktohen vizitat e sigurisë dhe mbrojtja e informacionit të klasifikuar ndërmjet shteteve. DSIK-ja si autoritet i sigurimit kombëtar nënshkruan marrëveshje në emër të Republikës së Shqipërisë së bashku me autoritetin e sigurisë kombëtare të shteteve palë.

Oerd Bylykbashi - Ka ndonjë gjë për të shtuar kolegu? Jo.

Faleminderit!

Në lidhje me relacionin nga ana e komisionit, fjalën e ka zoti Klosi.

Blendi Klosi - Kjo është marrëveshje kuadër dhe është rutinë për institucionin që e ka paraqitur. Përfaqësuesja e institucionit e tha se janë bërë marrëveshje me disa shtete.

Nga ana ligjore dhe procedurale, mendoj se është në përputhje me ligjin përkatës, me marrëdhëniet ndërmjet institucioneve dhe administratën publike shqiptare që mbulojnë këto raporte. Ka një qëndrim pozitiv qoftë nga Ministria e Jashtme, qoftë nga institucionet që kanë të bëjnë me informacionin e kualifikuar.

Në këto kushte, i propozoj komisionit, në cilësinë e relatorit miratimin e këtij projektligji dhe kalimin e tij për votim në seancë plenare.

Oerd Bylykbashi - Faleminderit, zoti Klosi!

Ka pyetje nga anëtarët e komisionit?

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Kam një pyetje më shumë për të qartësuar veten. Jam shumë dakord me marrëveshjen. Sa vende kanë mbetur ende pa bërë marrëveshje midis jush dhe vendeve të tjera të rajonit?

Marsida Fetishi - Jemi në proces negociatash me Kanadanë, Belgjikën, Lituaninë dhe Gjeorgjinë. Janë vende që ne kemi iniciuar këto negociata. Jemi në fazën fillestare. Kemi edhe me disa vende të tjera, por me to i kemi nisur negociatat. Në total, deri tani kemi nënshkruar 22 marrëveshje.

Oerd Bylykbashi - Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Kalojmë në diskutimin në parim. Ka ndonjë nga kolegët për të diskutuar? Nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te diskutimi nën për nen.

Neni 1. Ka pyetje? Nuk ka. Ka diskutime? Nuk ka.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet ky projektligj nga komisioni. Kjo ishte çështja e vetme për sot në rendin e ditës për Komisionin e Ligjeve.

Ju faleminderit!

Mbyllet mbledhja.

MBLEDHJA MBYLLET